



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada – Government**  
**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**  
**Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta - Ministry of Culture, Youth and Sport**  
**Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës/ Državna Agencija Kosovskih Arhiva/ Kosovo State**  
**Archives Agency**

Nr: 69/2024

Datë: 08.06.2024

Duke marrë parasysh nenin 12, 22 dhe 23 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), në pajtim me nenin 5 të Ligjit Nr.08/L – 111 për Arkivat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 30 / 5 shtator 2022), Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, Bislim Bislimi, nxjerr;

V E N D I M

1. Ndalohet shërbimi për palët sipas formës standarde aktuale të drejtpërdrejt për palët, përkatësisht qytetarët që parashtrajnë kërkesë për qasje në material arkivor – kategoria e kërkesave për qëllime sociale dhe juridike të qytetarëve, në arkivin qendror dhe arkivat ndërkomunale të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës (ASHAK).
2. Kërkesat si në pikën një (1) të këtij Vendimi, pranohen, shqyrtohen dhe administrohen vetëm përmes kanaleve zyrtare përkatësisht sistemeve që akordohen ndërmjet Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës dhe Postës së Kosovës Sh.A.
3. Obligohen zyrtaret përgjegjës të njësive arkivore në ASHAK të udhëzojnë palët që kërkesat për qasje në material arkivor t'i drejtojnë përmes zyrave postare të Postës së Kosovës Sh.A.
4. Obligohen arkivi qendror dhe arkivat ndërkomunale që të caktojnë zyrtaret përgjegjës për administrimin e kërkesave të pranuar në pikën e vetme të kontaktit për këtë lloj të kërkesave në ASHAK përmes postës, dhe që përmes pikës së njëjtë të kontaktit në ASHAK, të përgjigjen në kërkesat e palëve.
5. Obligohen departamentet dhe divizionet e ASHAK, të zbatojnë çdo detyrë që rrjedh nga procedura standarde operative e akorduar ndërmjet ASHAK dhe Postës së Kosovës, për funksionalizimin e formës së re të shërbimit për palët, si në pikën një (1) si dhe çdo detyrë tjetër për të siguruar zbatimin e aneksit të marrëveshjes për procedurën standarde operative.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Drejtorit Ekzekutiv të ASHAK;
- Drejtorëve të departamenteve të ASHAK;
- Arkivave ndërkomunale të ASHAK;
- Arkivit të ASHAK;

